



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.45, datë 28.09.2007

**“MBI SISTEMIMIN ME ZYRA TË NJËSIVE BASHKIAKE”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 8, pika II, gërma “a”, gërma “c”, neni 32, gërma “d”, V.K.M. Nr.153, dt. 03.04.1999 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, pika 2, gërma “ç”, Ligjin Nr.7850, dt.29.07.94 “Kodi civil”, neni 305, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Sistemimin e **Njesisë Bashkiake Nr.6** në objektin “Ish Komiteti Ekzekutiv” në Kombinat, me sipërfaqe totale prej 417 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimore 379 m<sup>2</sup>, që është pronë shtetërore, në ish vartësi të pushtetit lokal.
2. Kalimin kapital të ambientit “Ish-Reperti Termik”, i Ndërmarrjes Metalike “Tirana”, **Njesisë Bashkiake Nr. 11**, me këto të dhëna:

<i>Sipërfaqe Totale</i>	<i>321 m<sup>2</sup></i>
<i>(Sipërfaqe Ndërtimore)</i>	<i>321 m<sup>2</sup></i>

**Vlera Kontabël sipas Bilancit 31.12.2006 256.689 lekë**
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Njësitë Bashkiake Nr. 6, 11, Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtoreve të Qytetit, Ndërmarrja Metalike “Tirana”, Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SOKOL DERVISHAJ**

**K R Y E T A R**